



Kuvendi i Komunës Klinë

01/Nr prot. 06-32570 /2025

Datë: 25.09 /2025

Duke u mbështetur në nenin 40 paragrafi 2 shkronjën b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-048, Kornizën Afatmesme 2026-2028, nenin 40 paragrafi 2 nën pikën 2 të Statutit të Komunës së Klinës, Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 09.09.2025 dhe debatin me publikun më 16.09.2025, Kuvendi i Komunës së Klinës, në seancën e VIII- të të rregullt për vitin 2025 të mbajtur më 19.09.2025 mori këtë:

V E N D I M

Për

Aprovimin e propozim-buxhetit komunal për vitin 2026, përfshirë projektet kapitale

1. Miratohet buxheti i Komunës së Klinës për vitin **2026**, duke përfshirë të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet sipas kategorive ekonomike dhe projekteve kapitale.
2. Buxheti i përgjithshëm për vitin **2026** është në shumë totale prej **16,338,898 €**.
3. Buxheti përfshin:
 - a) Shpenzime të rregullta funksionale të institucioneve të Komunës;
 - b) Shpenzime kapitale për projekte me prioritet në infrastrukturë, arsimin, shëndetësinë, ambientin dhe shërbimet publike.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është buxheti i miratuar së bashku me projektet me prioritet për vitet **2026, 2027 dhe 2028** të cilat janë përfshirë në buxhet.
5. Kompetent për zbatimin e këtij vendimi janë Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.
6. Kryetari i Komunës është përgjegjës për koordinimin e zbatimit të projekteve dhe respektimin e buxhetit të miratuar.
7. Ky vendim hyn në fuqi **30** ditë pas dërgimit te autoriteti mbikëqyrës (MAPL), bazuar në Ligjin Nr.08/L-284, dhe pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Klinës.

Njoftohen:

- MAPL;
- Kryetari i Komunes;
- Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim;
- Zyra për Informim;
- Arkivi.

